



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

ERJONA VESHAJ

Erjona Veshaj mban pozicionin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), që prej muajit shtator 2025. Znj. Veshaj ka mbi një dekadë përvojë në arsimin publik, zhvillimin e politikave dhe koordinimin e bashkëpunimeve strategjike. Më parë ka shërbyer si Këshilltare për Marrëdhëniet me Jashtë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duke kontribuar në harmonizimin e reformave arsimore me standardet evropiane dhe në zhvillimin e partneriteteve strategjike.

Ajo ka gjithashtu përvojë të konsiderueshme në menaxhimin e programeve akademike dhe të shkëmbimeve edukative në institucione ndërkombëtare, si edhe përvojë në mësimdhënie.